



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCES

Njoftim për Mediat

Gjykata e Apelit lë në fuqi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës për hetimin në tregun e T.P.L ndaj kompanive të sigurimeve

Apeli: Vendimet për hapjen e hetimit nuk janë akte administrative dhe për rrjedhojë palët nuk mund të legjitimohen për kundërshtimin e tyre në gjykatë

Tiranë, 24 shtator 2008 Gjykata e Apelit Tiranë, ka rrëzuar padinë e bërë nga 6 shoqëri sigurimesh. Këto shoqëri kishin kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, anulimin tërësisht të vendimit nr. 45, dt 19 Janar 2007 të Komisionit të Konkurrencës, për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit ndaj palëve të treta (T.P.L.). Gjykata e Apelit e arsyetoi këtë vendim me faktin se vendimit që shërbejnë për hapjen e procedurave hetimore nga Sekretariati ashtu edhe nga Komisioni i Konkurrencës, nuk janë akte me karakter administrativ dhe për rrjedhojë palët nuk mund të legjitimohen për kundërshtimin e tyre në gjykatë.

Autoriteti i Konkurrencës, në mbështetje të ligjit 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, kishte hapur një hetim paraprak në tregun e sigurimeve të detyrueshme për periudhën 2005-2006. Në përfundim të këtij hetimi, Komisioni i Konkurrencës me vendimin 45, datë 19 janar 2007, u shpreh për hapjen e një hetimi të thelluar pasi u vunë re shkelje të konkurrencës në këtë treg. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 2372, dt. 3 prill 2007, hetimi i mëtejshëm i Autoritetit të Konkurrencës për T.P.L. ishte pezulluar.

Me marrjen e këtij vendimi, Autoriteti i Konkurrencës, ka rifilluar hetimet në tregun e sigurimit të detyrueshëm në Tregun Motorrik, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta si TPL e brendshme dhe Kartoni Jeshil.

Lidhur me policën kufitare, me vendimin nr. 50 të Komisionit të Konkurrencës, u vendos ndalimi i aktmarrëveshjes “Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorik”, e lidhur nga 8 shoqëri sigurimi: Sigma, Sigal, Atlantik, Intersig, Interalbanian, Albsig, Eurosig dhe Insig, si një marrëveshje e ndaluar me pasojë kufizuese për konkurrencën pasi fiksonte çmimin dhe ndante tregun. Edhe ky vendim i Komisionit të Konkurrencës u la në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Tiranë.

Komisioni me këtë vendim ka gjobitur në masën 2 % të xhiros së vitit 2005 të gjitha shoqëritë e sigurimit të përmendura më sipër. Në bazë të nenit 80 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” është Policia Tatimore organi i ngarkuar me vjeljen e këtyre gjobave. Ky

institucion është i detyruar që të vjelë këto gjopa dhe mund ta pezullojë këtë veprim vetëm në rast se vetë gjykata shprehet për pezullimin e ekzekutimit.

Deri tani Policia Tatimore, nuk e ka realizuar këtë detyrë funksionale të saj, me gjithë insistimet e herë pas hershme të AK dhe shqetësimin publik të Kuvendit dhe të Ministrit të Financave se po vonohet mbledhja e gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës duke ulur efektivitetin real të funksionimi të tij në treg.

Komisioni i Konkurrencës kërkon të sjellë në vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tregut, publikë dhe privatë, që në zbatim të ligjit të bashkëpunojmë për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, për një treg funksional me synim final, rritjen e mirëqenies së konsumatorit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

www.caa.gov.al
competition@caa.gov.al
Tel: +355 4 2234504
Fax: +355 4 2234497